



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



# “Kursimet për një të ardhme më të mirë”

Punimet e fituesve të konkursit për esetë më të mirë rreth kursimit dhe financave personale  
2019



## Përmbajtja

- Hyrje.....II
- Rëndësia e kursimit për të ardhmen- Jon Boqolli .....1
- KURSIMET për një të ardhme më të mirë- Albiona Barileva.....2-4
- Rëndësia e kursimit në të ardhmen- Etrid Thaçi.....5-6
- Mësimi për paranë në shkollë ndihmon se si të kursejmë- Era Shabani.....7
- Si mund të kursejmë!- Lis Ademi.....8
- Kursimet për një të ardhme më të mirë- Tuana Aliu.....9
- Mësimi për paranë në shkollë ndihmon se si të kursejmë- Krenare Shefqeti.10-11
- Rëndësia e kursimit për të ardhmen!- Elza Gosalci.....12-13
- Roli i parasë dhe kursimi në ekonomi!- Benar Sheqiri.....14
- Roli i parasë dhe kursimi në ekonomi!- Daorsa Imeri.....15-16


## Hyrje

Punimet në vijim janë përzgjedhur si esetë më të mira nga konkursi për ese, për kursimet dhe financat personale për vitin 2019.

Esetë janë punuar nga nxënësit e klasave 6-9 të shkollave fillore të Kosovës dhe përmbajnë njërën nga temat në vijim: rëndësia e kursimit për të ardhmen, qëndrimi i të rinjve ndaj kursimit, kursimet në institucionet financiare, mënyrat moderne kundrejt atyre klasike të pagesës, roli i parasë dhe kursimit në ekonomi, mësimi për paranë në shkollë ndihmon se si të kursejmë.

Esetë në vazhdim janë origjinale, kreative, imagjinare dhe jo domosdoshmërist paraqesin jetën private të autorit.





**Jon Boqolli- SHFMU "Hasan Prishtina", Prishtinë**

## **Rëndësia e kursimit për të ardhmen**

Kursimet janë të rëndësishme për secilin njeri që mendon për një të ardhme me të mirë apo edhe për ndonjë situatë të vështirë. Kur njeriu kursen apo ka një shumë të parave të kursyera ndjehet me i lumtur dhe me i sigurve për të ardhmen e vetë, sepse ai ka para që mundet të blejë me to kudo dhe çfarëdo që ai ka dëshirë, normalisht nëse i mjaftojnë ato para se shpesh herë dëshirat janë me të mëdha sesa mundësitë apo paratë që i kemi në dispozicion.

Po ashtu edhe për mua kursimet janë të rëndësishme sepse kur unë kam para të kursyera mundem të blejë çfarëdo që dua me ato para dhe nuk kam nevojë që t'i kërkoj Babit apo Mamin.

Unë kam filluar që të kursej para që nga mosha 6 vjeçare, kur kam filluar klasën e parë, këtë e kam bërë duke i vendosur paratë që unë i kurseja në një kutinë të vogël të kursimeve, këtë kuti i pata kërkuar Babit të ma blejë kur kam filluar klasën e parë me dëshirën që t'i ruajtur disa para për qëllim të blerjes së gjërave që unë i kam shumë për qejf.

Në fillim kam kursyer me qëllim për të blerë një "Howerboard" që kisha shumë dëshirë të shëtiti hipur në të, po ashtu të njëjtën dëshirë e kishte edhe vëllai im i vogël.

P.sh. unë bëj kursime kur shkoj në furre të bukës për të blerë një bukë babi apo mami mi jepe 50 centë, ndërsa buka kushton 40 cent dhe kusurin prej 10 centë, shpeshherë edhe shuma tjera i ruaj me pëlqimin e prindërve dhe i vendosi në kutinë time personale të kursimeve. Unë kursej edhe kur shkoj në market. Këtë e bëj duke i përcjellë reklamat e kursimeve që i bëjnë marketet në televizion, pastaj unë së bashku me Babin shkojmë në marketin që i ka ofruar zbritjet e atyre artikujve që ne kemi nevojë për t'i blerë.

Po ashtu unë kursej edhe kur shkojmë në qendrën tregtare Albi Mall për të blerë veshmbathje, këtë e bëj duke i shikuar fillimisht të gjitha dyqanet se cila ka ofruar zbritjen më të madhe për ata artikuj që kam nevojë për t'i blerë dhe kështu unë fitoj një pjesë të çmimit të zbritur të asaj që unë e paguaj, p.sh kur unë shkova me Babin dhe Mamin për t'i blerë pumat dhe trenerkat, ne vendosem t'i blejmë në dyqanin "INTERSPORT" pasi që mua me pëlqejnë produktet e tyre dhe po ashtu kishte ofruar një zbritje prej 40% dhe nga kjo zbritje e çmimeve kursyem një pjesë të parave, pra në vende se të paguaj 100 euro ne paguam vetëm 60 euro duke i kursyer 40 euro dhe prej tyre Babi mi dha 20 euro që t'i vendosi në kutinë time të kursimeve.

Unë kursimet i bëj për të blerë ato gjera që dëshiroi t'i kam qoftë për ditëlindjen time qoftë kur të shkoj në shkolle.

Kush kursen sot, në të ardhmen do të ketë me shumë para, me shumë pasuri dhe me shumë lumturi dhe unë i lusë prindërit e mi, shokët e klasës dhe të lagjes që të kursejnë sot për të ardhmen e tyre me të mirë.



**Albiona Barileva- SHMU- 2, Vushtrri**

## **KURSIMET për një të ardhme më të mirë**

Për Kursimin në familje dhe në shkollë.

Çfarë mund të them. Është pak e vështirë për mua të flas për një fjalë kaq të madhe dhe ndonjëherë edhe të paarritshme nga unë. Babai im punon rreth 12 ore çdo ditë për 5 ditë të javës si taksist dhe pushon vetëm në fundjavë që në fund të muajit të sjell ato pak euro në shtëpi. Ai shpesh mërzitet sepse nuk mund të bëj asgjë për këtë gjendje ku ne gjendemi. Prandaj ai përpiqet që të kursejë sa më shumë para për ne. Shumicën e kohës babi im qëndron me të njëjtat rroba për disa muaj sepse ai nuk i shpenzon paratë për rroba të shtrenjta por përpiqet t'i kursejë për librat dhe rrobat e mia dhe vëllezërve të mi. Mami tim nuk i intereson nëse shoqet e saja blejnë rroba dhe fustane të reja, asaj i intereson shkollimi jonë.

Mami im përdor derën e dhomës së miqve si tabele të zezë në të cilën me një shkumës të vogël ia shpjegon vëllait tim detyrat e matematikës dhe kursen para që të mos dërgojë vëllain tim nëpër kurse të shtrenjta.

Dajallarët e mi të cilët jetojnë në Tiranë më japin monedha që kanë vlerë rreth 100, 200 ose më shumë lekë të cilat unë i kam kursyer që vëllait tim të vogël t'i blejë një ambulancë që ka sa kohë që e kërkon.

Por kursimi nuk përfshin vetëm kursimin e parave. Unë kam dëgjuar se ka burra, gra dhe fëmijë në Afrikë të cilët janë duke vdekur për shkak të mungesës së ujit dhe ushqimit. Për këtë shkak ne duhet të kursejmë ujin dhe ushqimin që mos të gjejmë veten në këtë gjendje. Disa njerëz human disa nga kursimet e tyre ua dërgojnë këtyre njerëzve që kanë nevojë. Dhe kështu në këto vende njerëzit hapin shkolla, spitale dhe dërgojnë ujë, ushqime, barna etj.

Mua më pëlqen të vizatoj, është një ndër hobet e mia kryesore. Por gjithashtu në kohën time të lirë unë punoj origami nga letra. Vizatimi është e vetmja lende ku unë nuk mund të kursej ndjenjat e mia si lumturinë, trishtimin dhe ndonjëherë edhe dhimbjen gjatë prekjes së lapsit në letër. Për shkak të kësaj prindërit e mi përpiqen të më blejnë brusha, ngjyra tempera, lapsa etj, vetëm që unë të mund të vazhdoj këtë pasion.

Ndonjëherë kam shumë dëshirë që të shkoj në ndonjë shkollë të dizajneve. Por mua më shumë më intereson kursimi i parave për të hapur një shkollë falas në Vushtrri për fëmijë autik si vëllai im i vogël sepse të gjitha kopshtet në qytetin tim janë shumë të shtrenjta dhe asnjëra nuk pranon vëllain tim.

Prindërit e mi me ato kurse të vogla që kanë e dërgojnë vëllain nëpër çdo kopshte në qytet por kthehen të zhgënjyer. Vëllait tim i pëlqejnë shume kerret dhe për shkak të kësaj prindërit e mi japin edhe euron e fundit vetëm për t'i blerë ndonjë kerr policie ose zjarrfikës.

Por ndonjëherë unë kam dëshirë edhe të kursejë që të shkoj në plazh sepse mua më pëlqen shumë të notoj. Kemi kohe pa shkuar në plazh sepse ne më së shumti kursejmë për vëllain tim të vogël që ai të mund të arrijë shokët e tij.

Prandaj prindërit e mi kanë filluar të kursejnë para për një ide tjetër. Ata kanë planifikuar që me paratë e kursyera të mund të shpërngulemi në një shtet më të zhvilluar. Në këtë rast në Gjermani. Daja im na ka ndihmuar shumë duke na dërguar para që mamaja ime të kryejë Fakultetin si infermiere. Faleminderit Dajë! Edhe mami im gjithashtu mëson shumë dhe ka diplomuar dhe besoj që shpejt do punësohet .Por ajo ende duhet të mësojë gjermanisht dhe të shkojë të shoh nëse do e marrin në punë. Kjo do të jetë një e ardhme e ndritur për familjen time sidomos për vëllain tim, pasi ai do mund të shkojë në një shkollë profesionale që merren me fëmijë si ai. Ja sa e rëndësishme është kursimi.

Por siç thashë më parë kursimi nuk përfshin vetëm paratë ose ushqimin dhe ujin .Ajo përfshin edhe natyrën. Në çdo shtëpi ka të paktën një send që ka prejardhje nga natyra. Drunjtë e pyjeve priten që prej tyre të behën letrat, bankat, dollapet etj. Unë do të doja që një mënyrë tjetër e kursimit të jetë që librat dhe fletoret e vjetra të merren nga fabrikat dhe nga to të prodhohen letra të reja. Kështu do kursehej shumica e drunjtëve. Do të mund të bënim edhe kursimin e lapsave dhe kimikave në të njëjtën mënyrë.

Gjyshi im jeton në Tirane. Për gjithë jetën e tij ai ka kursyer dhe ruajtur të gjitha librat që i ka blerë dhe lexuar gjatë jetës së tij në nja librari. Kjo na ndihmon shumë sepse unë dhe të gjithë kushërinjtë e mi mund të shkojmë dhe të lexojmë ndër librat më të vjetër që shumica e njerëzve nuk kanë mundësi as ti shohin me sy. Unë kam mësuar nga Gjyshi dhe vete kam filluar të marrë të gjitha librat që kam lexuar gjatë jetës time dhe t'i ruaj me kujdes që vëllezërit e mi të lexojnë prej tyre. Por ne kemi edhe një mënyrë tjetër kursimi.

Mamaja ime kur ishte e re përdorte perin dhe me thurte rroba të ndryshme si triko, fustane, etj, që shumica me mbanin ngrohte gjate dimrit të ftohtë dhe të acartë. Gjë që na çon në kursimin e parave.

Në familjen time ne bëjmë edhe kursimin e rrobave të ndryshme. Nëse unë kam disa rroba që më bënin fiks para disa kohe por tani me bien të vogla unë nuk i hedh tutje por ia dërgoj vajzës së tezës e cila pastaj i vesh për vete dhe kur as asaj nuk i bien më ajo ja dërgon vajzës së vogël. Mua me pëlqen shumë kjo mënyrë e kursimit sepse ne nuk do kemi nevojë që të blejmë rroba të reja .Unë kam qenë në shkollën e muzikës për rreth 4 vjet. Për shkak të rrogës së vogël të babit tim ai nuk mund të më blinte një violinë fringo të re. Prandaj ai me paratë e tij më ka blerë një violinë pak të përdorur por që funksiononte për mrekulli. Unë këtë violinë para katër vjetësh duke ushtruar me të e lashë mbi dollap sepse nuk kisha aq kohë që ta luaja. Më vonë mora vesh që vajza e tezës donte të mësonte të luante violinën dhe mezi priste që

prindërit t'ia blinin një violinë. Pra që t'i kursente paratë dhe të mos e blinte violinën unë vendosa që t'ia dhuroj violinën. Ajo ka filluar të luaj violinën dhe jam shumë e gëzuar që e kam ndihmuar me të. Gjithashtu në shkollën time ShMU 2 është një traditë e bukur që në dimër kush



ka rroba të tepërta i bëjnë në formë dhuratash dhe i çojnë në shkollë për ata fëmijë të cilët nuk kanë, kështu ju ndihmojnë moshatareve të tyre. Dhe kur ndonjë shok apo shoqe klase nuk ka me çfarë t'i blejë librat ndonjë prind i fëmijës tjetër ia blen dhe kështu mësojnë edhe ata fëmije që nuk i kanë kushtet.

Unë kam menduar edhe të bëj shumë kartolina të ndryshme dhe t'ia shes me çmim të arsyeshëm ndonjë dyqani për festën e Mësuesit ose të Nënës dhe të kursej ca para për të ardhmen që kur të rritem t'i realizoj të gjitha ëndrrat e mia dhe të prindërve të mi. Mësuesit dhe Mësueset e mia më thonë që nëse mësoj dhe punoj shumë do të arrij por edhe nëse kursej do të jetë më e lehtë që të zgjedh një profesion për të siguruar jetën time dhe të familjes së ardhshme. Shpresoj që t'ia arrij së bashku me vëllain tim të madh dhe vëllain e vogël që në të ardhmen të bëhemi qytetarë të denjë të Kosovës dhe kursimet tona t'i vendosim në bankë për familjet tona të ardhshme që nesër me kursimet tona të ndërtohet më shumë Shteti ynë i ri. Gjithashtu fëmijët e mi nesër të kenë kushte më të mira në shkollë, në spital, në Bibliotekë dhe kudo në qytetin e tyre të bukur. Kjo tregon që me pak kursime shumë gjëra mund të realizohen.

Kursimi i sendeve tuaja dhe dërgimi i tyre tek njerëzit që kanë nevojë është gjë shumë e mirë. Kursimi i pyjeve ushqimeve ujit rrobave librat do na ndihmojë për një të ardhme më të mirë dhe më të ndritur. Unë gjithmonë kam bërë kursime shumë të vogla të cilat nuk i kam quajtur me vlerë për shkak se s'ka qenë kursim aq i madh. Por edhe kursimi më i vogël mund të ndihmojë prindërit e tu, ty, anëtarët e familjes tënde,

dhe gjithë komunitetin ku jeton. Unë ende mund të mos e kuptoj fjalën: "Kursim,, por unë e di që nëse të gjithë kursejmë Shteti ynë i vogël do të arrijë të bëhet zhvillohet shumë shpejt si në rrugën e dijes ashtu edhe në ekonominë e saj. Prandaj ne duhet të kursejmë sa të kemi mundësi që asnjëherë të mos kemi borxhe por të ecim kryelartë me punën tonë të përditshme dhe ta ruajmë natyrën, shkollën, librat dhe gjithçka tjetër që mundemi që të jemi shembull për brezat e ardhshëm siç janë Prindërit tanë për ne dhe siç kanë qenë Prindërit e tyre për ta. Pra kjo është për mua Kursimi është ajo fjalë që me anë të saj arrin gjithçka që do të bëhet realitet pavarësisht moshës që ke.





**Etrid Thaçi**- SHFMU-“Metush Krasniqi”, Rogoqicë,  
Komuna e Kamenicës

## **Rëndësia e kursimit në të ardhmen**

Para se të kuptojmë se çfarë paraqet kursimi është shumë e rëndësishme të cekim se paraja është mjet me të cilën plotësojmë nevojat personale, si dhe për një jetë sa më të mirë. Gjithashtu me anë të parasë ne mund t'i kemi gjërat që dëshirojmë.

Para shumë vitesh ,në kohët e më hershme, paraja nuk ka ekzistuar por gjërat e nevojshme janë ndërruar mall me mall, p.sh. ka ekzistuar një vend i caktuar sikurse në ditët e sotme që kemi vendin e tregjeve ,edhe në atë kohë njerëzit kanë kultivuar ushqime të ndryshme ,ku ata kanë bërë ndërrimin e mallrave si: njëri ka dhënë miellin ndërsa tjetri ka dhënë patatet. Ndërsa me kalimin e kohës është përdorur ari, argjendi pastaj dinari, marka e tash euro. Këto informata ende nuk i kemi mësuar në shkollë por mua më ka treguar gjyshi im. Ai thotë se janë edhe disa lloje të parasë si dollari dhe franga. Ka edhe të tjera , por gjyshi im i di vetëm këto të cilat cekën në këtë shkrim,

Ne në shkollë përpos shkrim, leximit dhe njohuri të ndryshme që mësojmë ,ne disa gjëra i mësojmë edhe përmes anëtarëve të familjes si dhe nga rrethi që na shoqëron, Ndërsa sa i përket rëndësisë së kursimeve në të ardhmen ,unë këtë shprehje e kam filluar qysh i vogël por në mënyra të ndryshme, apo të them në faza të ndryshme. Si fillim në mënyrë argëtimi,

Sipas mamit, unë kur kam mbushur 6 muaj, më ka hapur një llogari në një bankë ku aty ka lënë paratë që kishte grumbulluar nga dhuratat e familjarëve për lindjen time. Pastaj kur kisha mbushur 9 muaj më kishte dërguar në çerdhe ,Një ditë kishin ardhur punëtorët e bankës për të na treguar rreth kursimeve në mënyrën ne si e kuptojmë, ndërsa prindërit t'i motivojnë që të kursejnë. Qëllimi i tyre ishte që ne të hapim nga një llogari që të kursejmë aq sa kemi mundësi që ne kur të rritemi të kemi mundësi t'i përdorim ato para të kursyera nëse ne hasim në ndonjë vështirësi, apo për të plotësuar ndonjë dëshirë . Edukatorët caktuan ditën të cilën ne do të shkojmë bashkë me edukatorët dhe prindërit tanë. Unë kisha llogari të hapur më parë, ndërsa fëmijët të cilët nuk kishin llogari në bankë i hapen. Punëtorët e bankës na dhanë nga disa dhurata dhe një arkë, ku ne sa herë që dikush na jep para për ndonjë festë apo datëlindje t'i hedhim në arkë dhe pasi të mbushet, së bashku me prindërit t'i dërgojmë në bankë. Kështu ne edukoheshim për të kursyer në mënyrë argëtimi,sa herë që kishim para ne vraponim për t'i hedhur në arkë ,ku zhurma kur hidhnim paratë në arkë, krijonte tinguj të cilat na bënë të lumtur. Pastaj duke u rritur ndryshonte loja për kursime, gjithashtu ta quaj një lloj gare ku unë dhe vëllai im bëmë gara cili po e mbushte më shpejtë arkën që të shkojmë në bankë për t'i kursyer. Mirëpo, tash në moshën që kam, për rëndësinë e kursimeve në të ardhmen nuk do të them se është një lojë, si më herët që kisha argëtimin apo garën. Sikurse



që isha foshnjë, duke u rritur fillova të ecja, pastaj mësova të flas, të shkruaj ,të lexoj. Ashtu edhe shprehia e kursimeve fillimisht ishte një argëtim, një garë ,pastaj fillova ta kuptoj më ndryshe dhe më e arsyeshme .E tash mund të them se të kursesh është diçka e mirë dhe e nevojshme. Sidomos kur jeton në fshat dhe duhet të udhëtosh për në kurse, që është e domosdoshme për të përvetësuar më shumë e që duhet edhe të shpenzosh para. Gjithashtu ,shkollimin e mëtutjeshëm që mendoj ta realizoj ëndrrën që kam të bëhem arkitekt . Duke e kuptuar që ky drejtim kërkon para dhe duhet siguruar edhe udhëtimin atëherë patjetër që duhet të kursej. Kursimet varen edhe nga parat që kanë prindërit ,sa më shumë të kemi të hyra ,ne mundemi edhe të kursejmë më shumë, por nëse të hyrat janë të pakta atëherë ne kemi vështirësi për të kursyer. E për të mos pasur vështirësi, ne duhet të mos bëjmë harxhime të panevojshme, pasi qe ne në mënyrë të pavetëdijshme harxhojmë pa kontroll vetëm për t'i plotësuar vetes dëshirat duke mos menduar fare për vështirësitë që i kanë prindërit tanë. Por edhe pse ne nuk mundemi të punojmë e të kemi para ,ne mund të mos harxhojmë e të kursejmë aq sa kemi mundësi .Që në këtë mënyrë të kursejmë për të ardhmen si dhe t'ia lehtësojmë prindërve tanë mënyrën për shkollimin tonë.

Andaj për të gjithë fëmijët sidomos moshatarët e mi, kam një porosi sa i përket rëndësisë së kursimeve: mos harxhoni para për gjëra jo të rëndësishme, por kurseni ju që t'i ndihmoni vetes tuaj dhe t'ia lehtësoni prindërit e juaj.

**Unë tashmë e kuptoj rëndësinë e kursimit për të ardhmen ,si dhe jam duke kursyer,...po ju?**





## Mësimi për paranë në shkollë ndihmon se si të kursejmë


Paraja është mjaft e rëndësishme në botën bashkëkohore. Ajo përcakton nivelin e standardit material jetësor. Për kursimin e parasë njeriu duhet të mësoj qysh në një moshë të re. Prindërit duhet t'i mësojnë fëmijët se paratë nuk duhet shpenzuar vend e pa vend. Duhet mësuar se paratë që ata mund t'i fitojnë në formë dhuratash duhet t'i ruajnë apo kursejnë. Kjo mund të bëhet duke mbajtur nga një arkë të vogël kursyese. Një mini bankë. Kur fëmijët të arrijnë moshën shkollore, ata përveç lëndëve të ndryshme duhet mësuar edhe për paratë, si e mirë materiale. Duhet mësuar se paratë duhet të fitohen me mund, të shpenzohen me vend dhe me vlerë. Një shembull i mirë është me arkën e kursimit. Fëmijët, paratë që i kursejnë aty duhet të mësohen t'i shpenzojnë vetëm për gjëra të domosdoshme, të nevojshme.

Mësimi për ekonominë dhe financat në shkollë i ndihmon nxënësit që të kenë një të ardhme më të mirë. Por, mësimi për kursimet dhe financat nuk duhet të zgjasë vetëm për një kohë të shkurtër, kjo duhet të zgjasë deri në klasën e dhjetë, kur nxënësit të kenë arritur pjekurinë e nevojshme për të kuptuar se paraja nuk i zotëron ata, por ata zotërojnë me paranë. Thënë më qartë, kursimi duhet të bëhet përditshmëri.

Domethënë mësimi për paranë duhet të fillon që nga një moshë e hershme në familje dhe për të vazhdohet të mësohet në shkollë. Gjatë gjithë këtyre viteve nxënësit duhet të mësohen të kursejnë dhe si të veprojnë me paranë, që kur të rriten të mos kenë probleme se për çfarë dhe ku t'i shpenzojnë paratë. Përveç tjerash, të kursyerit e parasë ka anën pozitive të krijimit të ndjenjës së humanitetit qysh në fëmijëri.

Si mund të ndodh kjo?

Me paratë e kursyera, fëmijët kur të rriten, mund të ju ndihmojnë fëmijëve me nevojë, të cilët përballen me varfëri. Kështu, këtyre fëmijëve, me kontributet tona, mund t'ju ndihmojmë që ata t'i realizojnë ëndrrat e tyre për shkollim. Në këtë mënyrë ne jo vetëm që ndihmojmë që këta fëmijë të jenë të lumtur, por edhe kontribuojmë në të mirë të gjithë njerëzimit.



## Si mund të kursejmë!

Ne fëmijët e kohës së sotme kemi shumë mundësi dhe burime informacionesh nga çdo anë. Madje, madje kemi edhe në shkollë një lëndë zgjedhore që ne mundemi ta zgjedhim çdo vit shkollor. Nëse kemi mundësi dhe kërkojmë që në këtë lëndë zgjedhore të mësojmë në lidhje me paranë dhe mënyrën se si të kursejmë. Që nga moshë e vogël apo fëmijëria e hershme fillon mbjellja e kulturës dhe kultivohen vlerat ekonomike në familje dhe pastaj në shkollë e më vonë edhe në shoqëri.

Në familje marrim hapat e parë se si duhet të kursejmë, si duhet të kujdesemi për gjërat tona, si duhet ti ruajmë ato pasi që prindërit harxhojnë për blerjen e tyre. Më vonë mësojmë edhe në shkollë se si duhet ruajtur gjërat shkollore dhe inventari i shkollës, mësojmë po ashtu për monedhat, ndarja e tyre, llojet e monedhave, vlera e tyre, por nuk është mjaftueshëm për kërkesat tona në mënyrë që të jemi edhe më të informuar rreth kursimeve, bankave, kartelave dhe çdo gjë rreth ekonomisë.

Unë kam një arkë të vogël në dhomën time, dhe qysh kur kam qenë i vogël kam futur monedhat në të, dhe shumë, shumë ndjej kënaqësi kur mbushet arka ime dhe unë kam mundësi të hapi atë dhe të blej gjërat që i dëshiroj dhe që kam nevojë.

Ndihem shumë krenar kur për ditëlindjen e vëllait tim unë blej dhuratë nga paratë e mia të kursimeve, apo edhe shpesh bëj surpriza në shtëpi për ndonjë blerje. Po ashtu kam edhe llogarinë time bankare të cilën e mirëmbajnë prindërit e mi dhe kursejnë të holla për mua në mënyrë që kur të rritem të shkollohem dhe po ashtu të kem një pasqyrë edukimi ekonomik- si duhet të rritem dhe të mësoj të kursej!





**Tuana Aliu- SHFMU-“Pjetër Bogdani”, Prishtinë**

## **Kursimet për një të ardhme më të mirë**

Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që ka paraja në jetën e secilit njeri. Ndoshta me para nuk është e mundur të blihet çdo gjë por lirisht mund të themi se ajo na përcakton shpeshherë cilësinë e jetës sonë. Sikur edhe të gjithë

moshatarët e mi, në aspektin financiar ende varem nga prindërit. Ata përveç që financojnë shkollimin tim dhe të gjitha aktivitetet e tjera që unë kam, përherë kujdesen që të më tregojnë se sa e rëndësishme është të kursesh. Secili prej nesh mund të kursej varësisht mundësive financiare. Kursimi na mundëson që të planifikojmë shpenzimet tona në të ardhmen. Kursimi i parave qysh nga kjo moshe, na mundëson neve që të krijojmë pavarësi financiare për studimet tona apo çfarëdo investimi tjetër që duam të bëjmë në të ardhmen. Shume ëndrra tona, shume dëshira apo synime do të mund t'i realizonim shumë më lehtë nëse arrijmë të kursejmë për periudhe me te gjate kohore.

Besoj që secili nga moshatarë e mi ka dëshirë që jo gjithmonë të varet nga prindërit e tij sa i përket parave. Secili prej nesh duam që të kemi paratë tona qofte edhe për t'i bërë një dhurate prindërve, shokëve/shoqeve apo për të përmbushur kërkesat tona afatgjata.

Është shumë i rëndësishëm fakti që ne të krijojmë shprehi të kursimeve ashtu që t'i mundësojmë vetes një të ardhme më cilësore dhe më të pavarur në aspektin financiar.

Jeta jonë e përditshme ka pësuar shumë ndryshime nga jeta që prindërit e gjyshërit e mi kanë pasur në të kaluarën me ç'rast kërkesat dhe shpenzimet tona qoftë si fëmijë

apo si të rritur kanë ndryshuar po ashtu shumë. Pavarësisht kësaj, ne duhet të jemi më të kujdesshëm në mënyrën se si i shpenzojmë paratë. Siç thuhet në një

shprehje të njohur: “Mos kurseni atë që ka mbetur pas shpenzimit; në vend të kësaj shpenzoni atë që ka mbetur pas kursimit”.

Kursimin lirisht mund ta shohim si një investim personal për të ardhmen. Për fatin tonë

të mirë, kemi mjaft institucione financiare në vend në të cilat ne mund të vendosim kursimet tona. Kjo në njërin anë do t'i shërbente shumë ekonomisë së vendit dhe në anën tjetër ekonomive familjare.

Si përfundim, kursimi mund të na sjellë shumë përfitime, prandaj të jemi të kujdesshëm në këtë aspekt që të kemi një të ardhme më cilësore.

**Kursimi nuk është koprraci, por është mençuri!**



**Krenare Shefqeti- SHFMU-"Hilmi Rakovica", Prishtinë**

## **Mësimi për paranë në shkollë ndihmon se si të kursejmë**

Ne jemi fëmijë. Por kjo nuk do të thotë që të mos mendojmë për të ardhmen e për atë që na pret .Në jetën tonë të përditshme, bëjnë pjesë edhe paratë ,dhe paratë janë një mjet i rëndësishëm jetese sidomos ditëve të

sotme. Ne mund të pyesim "Si do të mund t'i sigurojmë të hollat në të ardhmen"?

Për këtë na ndihmon kursimi. Kursimi është mënyra më e mirë rreth planifikimit të se ardhmes. Rreth kursimit dhe financave mësojmë edhe në shkollë. Se sa me rëndësi është të kursyerit e shpjegojnë edhe shumë fakte, thënie, dhe edhe tekstet shkollore. Mendoj që vetëdijesimi i popullatës e në veqanti vetëdijesimi i të rinjve për të kursyer mund të ndihmojë shumë në zhvillimin e mëtutjeshëm të shtetit. Duke ndarë një pjesë të të hollave që ne marrim çdo ditë, do të shohim që dalë nga dalë do grumbullojmë më shumë dhe do ta kuptojmë që kjo është mënyra më e mirë e kursimit .Do të ishte shumë sikur do mund ta kthenim kursimin në përgjegjësi sepse duke parë çdo muaj sa kemi kursyer do motivoheshim çdo ditë e më shumë. Populli thotë" Është më mirë një kursim se sa një fitim", dhe mendoj që është e vërtetë sepse kur kursen edhe mund të fitosh. Në shkolla mësojmë shumë për kursimet, shërbimet financiare, profesionet dhe të gjitha këto kanë lidhje me paratë. Dhe duke e kthyer kursimin në shprehje që nga kjo kohë kur jemi të fëmijë e deri në kohën kur do rritemi e do bëhemi të zotët e vetes, deri atëherë kur do të punojmë,do të na ndihmojë shumë edhe në planifikimin e gjërave, në jetën tonë. Paratë e kursyera mundemi që më pas t'i përdorim edhe në raste të ndryshme,qoftë dëshirë qoftë edhe nevojë që ne do të kemi. Fëmijët anembanë botës, mësohen që në kohën kur janë të vegjël të kursejnë dhe kjo është me të vërtetë një gjë e mirë sepse siç e përmendëm më lart duke kursyer fiton. Është e vërtetë që në kohën sa jemi të vegjël ne mbështetemi shumë tek prindërit. Por ne na përkujtojnë edhe në shkollë që duhet të udhëtojmë pak në të ardhmen, se dikur do bëhemi të zotët e vetvetes. Kursimi është një nga mënyrat që na ndihmon t'i menaxhojmë më mirë problemet ,e sidomos problemet financiare.

Paraja është mjet pagese që çdo ditë e më shumë po bëhet më e rëndësishme. Ne jemi njerëz dhe për disa prej nesh mund të jetë hera e parë që vendosim të kursejmë, por nuk duhet harruar që," Ka gjithmonë një herë të parë për gjithçka",dhe me kalimin e kohës të gjithë do e vërejmë se kursimi i parave është shumë i dobishëm. Në kohët e lashta kur nuk ka

ekzistuar paraja, njerëzit kanë jetuar duke shkëmbyer gjëra. Nga kjo mund të nxjerrim se jo vetëm paraja mund të kursehet, por duke parë se sa mjet i rëndësishëm që po bëhet paraja nga dita në ditë sapo ta përmendim fjalën "kursim", menjëherë na kujtohen paratë.

Bankat janë shërbime financiare që i shërbejnë secilit individ. Shumica e personave të rritur i ruajnë paratë e tyre dhe kursimet e tyre në banka dhe kjo është një zgjedhje me të vërtetë e mirë dhe e sigurt.

Por përpos të rriturve edhe ne fëmijët mund të kursejmë. Dhe mund të fillojmë duke kursyer të hollat që marrim, në shtëpi ndërsa kur të rritemi dhe ne do të mund t'i shfrytëzojmë bankat, për t'i kursyer e më pas për t'i ruajtur paratë.

Në ditët e sotme njerëzit nuk kanë motiv e as dëshirë për kursimin dhe e shohin si diçka të panevojshme në jetën e tyre, sepse të hollat i sigurojnë gjithsesi. Por unë mendoj që secili prej nesh duhet vetëdijësuar, se nuk i dihet një ditë, do mund të na duhen për çfarëdo lloj urgjence dhe nuk ke pse brengosesh kur kujton se ke kursyer.

Është e vërtetë që fëmijët ,mësojnë nga të rriturit. Dhe në qoftë se të rriturit kursejnë dhe e shfrytëzojnë paratë me mençuri, padyshim që ashtu do të bëjnë edhe fëmijët. Secili do mësonte më shumë rreth kursimeve.

Këto ditë,paraja edhe keqpërdoret nga disa persona që nuk e dinë se si shfrytëzohet ky mjet. Dhe nganjëherë është e vërtetë që sa më shumë të kesh aq më lakmitar do të bëhesh. Nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë kurrë turp të kursesh, prandaj -Kur kemi një rast të ndryshojmë për mirë, përse të mos e bëjmë? Nga të gjitha faktet dhe gjërat që dimë për kursimin mund të përfundojmë se është një fakt shumë i dobishëm sa i përket planifikimit të së ardhmes!





**Elza Gosalci- SHFMU-“Pavarësia”, Prishtinë**

## **Rëndësia e kursimit për të ardhmen!**

Isha ulur pranë dritares sime, duke shikuar shiun që po binte përjashta. Ishte vrenjtur koha, ndërsa unë po mendoja me vete. Kursimet e mia po mbaronin dhe ende nuk kishte ardhur fundi i muajit. Rëndësia e kursimeve për mua ishte shumë e madhe! Po t'më pyesje disa muaj më parë, do të habiteshit nga përgjigjja ime! Mua, asnjëherë s'më kishte shkuar mendja të kurseja para, sepse nuk më mungonin asnjëherë. Nuk e dija rëndësinë e tyre. Isha vetëm një fëmijë i llastuar që nuk ndjente mungesën e asgjëje! Por tani po e kuptoj gabimin që e kam bërë! Po t'i kurseja paratë me kohë, tani që më nevojiten kaq shumë, do t'i kisha dhe do t'i ndihmoja nënës time të sëmurë.

Disa muaj më parë nëna ime u sëmurë, por për ta ndihmuar atë më nevojiteshin një shumë e madhe parash. Babai më kishte vdekur. Nëna ishte në spital. Motra ime po punonte ditë e natë që të sillte më shumë para. Si t'i ndihmoja unë?! Isha një vajzë 14 vjeçare pa figurë atërore që me ndihmën e motrës mendohej të shpëtonte të ëmën. Si t'ia bëja?

Dola dhe për herë të parë në jetë po kërkoja punë. Nuk më pranuan askund, por nuk u dorëzoza vazhdoza të kërkoja. Kërkova por u dëshpërova! Nuk më pranuan për shkak të moshës që kisha. Frika më kaploi trupin dhe mendjen time. Po mundohesha të vija në vete. Pas disa minutash u nisa të shkoj në shtëpi. Pasi mbërrita një fije shprese lindi në zemrën time, duke e bërë atë të rrihte shumë shpejt nga emocionet. Pashë një lajmërim ku thoshte se kishin nevojë për dado. E mora fletën dhe nxitova ta thërrisja numrin që ishte i shkruar. Pas një bisede të gjatë me zonjën (mamanë) e foshnjës, më pranoi. Ajo tha se do të më paguante 10 euro për çdo ditë. Sigurisht se unë pranova. Kujdesesha për vajzën e saj 4 vjeçe nga ora 1 deri në orën 10 të mbrëmjes për 5 ditë të javës.

Unë kurseja nga 300 euro nga zonja. Por si t'i kurseja e mos ti shpenzoja kot? Nëna kishte thënë se kam një xhirrollogari në bankë.

Nxitova duke vrapuar tek banka. Për fat ajo ishte e hapur, hyra dhe bisedova me zonjën aty. I thash se dua t' deponoj disa para. Ajo më ndihmoi. M'i shpjegoi se si t'i kurseja paratë, madje më tregoi se rëndësia e kursimit të parave ishte shumë e rëndësishme për të ardhmen por unë e kisha kuptuar tashmë.

Dola shumë e lumtur nga banka dhe shkova pranë nënës, e cila ishte zbehur nga frika dhe sytë i kishte të skuqur dhe vërehej se kishte qarë, por u mundua ta fshihte këtë. Ajo buzëqeshi dhe më përqafoi. E putha në ballë e i tregova se po punoj, se kam qenë në bankë dhe po kurseja për ta ndihmuar.



Shprehja e fytyrës së nënës ndryshoj sikur ndjente një barrë nga kraharori t'i largohej, ajo ishte shumë e lumtur, e shtrëngova fortë e i thash se do të bëja çdo gjë që të të ndihmoj. Nuk kam askënd tjetër përveç teje.

Ajo qeshi e hutuar. E pyeta se pse qesh? Sepse është dita më e bukur – u përgjigj nëna ime. Mbeta pa fjalë! Deri sa jashtë po binte shi dhe bënë ftohtë, nëna tha se brenda meje dielli po shkëlqen me rrezet e tij në zemrën time.

Vogëlushja ime ti ke mësuar një mësim për tërë jetën. Kursimet janë shumë të rëndësishme për të tashmen dhe të ardhmen, për ty dhe për të gjithë, sepse nuk dihet kur të duhen, je rritur shumë dhe je bërë më e pjekur. Ke mësuar të kursesh, të përdorësh, të punosh, t'i deponosh paratë në bankë dhe t'i nxjerrësh ato nga banka, për deri sa kur ishe fëmijë nuk ke ditur të kursesh, gjithmonë ke blerë rroba të shtrenjta, lodra dhe ke shpenzuar shumë në gjëra të kota. Tani po kursen për mua. Kështu më fliste nëna.

Zemra ime ndaloi dhe qava. Më fal nën! Tani e tutje gjithmonë do të kem kursim. I kam shitur rrobat e shtrenjta dhe i kam shitur lodrat zonjës për të cilën punoj. Kam pastruar shtëpinë për të marrë më shumë para. Kam gatuar edhe darkën që të më shtonte disa para më shumë në pagën time. Ajo kishte edhe një këlysh të vogël, të cilin e nxirrja për shëtitje kur zonja kishte ndonjë punë. Në vikend më thërriste të kujdesesha për vogëlushen e saj dhe më paguante 20 euro ditën.

Nuk kam shpenzuar aspak. I kam kursyer. Jeta më mësoi se nëse nuk kursejmë nuk do të mund të ballafaqohesh në të ardhmen, sepse për një të ardhme më të ndritur do të nevojiten parat e tua. Nuk ka rëndësi se për çfarë nevojite: për shkollim, për sëmundje apo për argëtim.







**Benar Sheqiri- SHFMU-“Pavarësia”, Prishtinë**

### **Roli i parasë dhe kursimi në ekonomi!**

Qysh në kohërat e lashta njerëzit janë marrë me bujqësi, peshkatari e punë të ndryshme për përfitime financiare. Ata, me shumë mund, djersë e sakrificë kanë punuar vetëm e vetëm të fitojnë para për një jetë më të mirë.

Në të kakuarën paraja ishte në forma të ndryshme, një herë në formë ari, pastaj në formë monedhe, e kartë monedhe. Në secilën formë paraja ka pasur një rol të rëndësishëm për jetën e njeriut. Me një fjalë, paraja ishte dhe është burim i ekzistencës dhe të ardhurave materiale të njeriut.

Që të kemi një të ardhme më të mirë, ne duhet që të kursejmë para dhe mos të shpenzojmë kot vend e pa vend. Nëse ne i kursejmë dhe i grumbullojmë mund të kemi një ekonomi më të mirë, siç thotë një fjalë e urtë popullore “gurë – gurë bëhet kalaja”. Edhe ne, nëse kursejmë mund të hapim ndonjë biznes e të kemi më shumë të ardhura materiale.

Gjithashtu mund të ju ndihmojmë njerëzve në nevojë, si dhe të punësojmë shumë njerëz dhe të gëzojmë shumë familje.

Kursimi në ekonomi mund ta rritë prodhimtarinë dhe biznesin, pastaj çdo njeri të ketë një të ardhme dhe jetë më të mirë.

Vendi për t'i ruajtur paratë është banka.



## Roli i parësë dhe kursimi në ekonomi

Ne, të gjithë e dimë se fjala "para" çfarë do të thotë! E dimë gjithashtu se është pjesë e pandashme në jetën dhe përditshmërinë tonë. Por kursimi i saj për një jetë më të mirë a thua e dimë se çfarë është?

Të kesh para nuk do të thotë t'i shpenzosh të gjitha me pretekstin "kam mjaft dhe nuk do t'ua ndiej mungesën këtyre", por them që sa para të shpenzohen, po aq të mundohemi t'i kursejmë, ose më konkretisht të bëhet një balancim mes tyre.

Paraja përcaktohet edhe nga funksioni dhe shërbim që ajo na ofron.

Paraja ka katër funksione themelore, ku merret si: njësi llogaritëse, dyqan vlerash, medium këmbimi dhe standard i pagesës së shtyrë.

E nëse flasim për ekonominë në Kosovë, do të shohim se kemi të bëjmë me një numër të madh të njerëzve për të cilët është e pamundur të kursehet.

Të ardhurat që ata marrin janë të mjaftueshme vetëm për nevoja personale dhe jo të mjaftueshme për të gjitha kërkesat që ata kanë. Ndërsa nëse dalim tek vendet e sigurta për të ruajtur apo kursyer përveç xhepat tanë, mund të përmendim edhe bankat, si institucione financiare, të cilat gjithashtu merren me kursimin, dhënien dhe ruajtjen e parave.

Bankat gjithashtu merren edhe me mundësimin e marrjes së parave në këmbim të diçkaje apo marrjen e tyre me kredi duke i kthyer me pjesë.

Kursimet fillojnë që nga mosha të vogla e deri në mosha më të rritura. Për kursimin e parave në banka, duhet të hapen xhirollogari, fillimisht nga prindërit e pastaj në moshën 18 vjeçare të merret në mbikëqyrjen e personit që ka të drejtë ta marrë.

Prindërit e mi çdo muaj fusin para në konton time, që kursimet që bëhen për mua të më hyjnë në punë në të ardhmen nëse dua të kryej studime jashtë vendit apo për gjëra që dua.

Kalojmë tek pjesa tjetër e temës ku desha gjithashtu të flas për buxhetin.

Plani financiar kryesor i një shteti ose të ardhurat e një familje, një njeriu etj, krijojnë një buxhet.

Shumë njerëz nuk binden se kanë nevojë për një buxhet, disa njerëz e ndiejnë nevojën që të krijojnë një buxhet personal dhe disa të tjerë nuk dëshirojnë që shpenzimet e tyre t'i kufizojnë. Pra ekzistojnë lloje të ndryshme të mendimeve për buxhetin, dhe sigurisht që nuk ke pse të jesh vetëm ekonomist që të krijosh buxhetin tënd personal.

Por cilat janë ato të mira që krijimi i buxhetit sjell tek ne?

Përgjigjet e kësaj pyetje janë të ndryshme për çdo njeri.

Ndërsa mendimi im është se jemi gjithmonë në dijeninë e gjendjes tonë financiare, na jep mundësinë të dimë sa të ardhura kemi, e sigurisht që na jep dhe mundësinë të kursejmë dhe të kemi më shumë para në xhepat tanë.

E nëse kalojmë te buxheti i Kosovës atëherë do të shohim se kemi të bëjmë me një ndër vendet që hyjnë në grupin e vendeve më të dobëta për nga aspekti ekonomik, fakt ky me të cilin nuk dihet të menaxhohet ose të shpenzohen dhe të kursehen para në raste të caktuara. Pra, dua të them që shumimi dhe kursimi i parave te ne si shtet është në përqindje të vogël, pavarësisht se mundësitë për të pasur një jetë më të mirë qytetarët nga të ardhurat ekonomike mund të jenë shumë më të mëdha, prape ata detyrohen të emigrojnë në vende të tjera për një jetë më të mirë dhe për të siguruar të ardhurat e tyre ekonomike. Ne dimë që për përfitimin e të hollave duhet të punojmë, dhe për të punuar ne duhet të mësojmë për një të ardhur më të ndritur. Andaj ftoj të gjithë bashkëmoshatarët e mi që të mësojmë dhe puna jonë më vonë të shpërblehet. Paraja pra është shumë e vlefshme, por fillimisht të mundohemi ta dimë vlerën se si e fitojmë atë.



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Rr. Garibaldi nr.33, Prishtinë, Kosovë  
+383 38 222 055  
[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)